



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri
Mbledhja nr. 08
Data 29. 05. 2008

P R O C E S V E R B A L

Mbledhjen e kryesoi:
Rrustem Mustafa, kryetar i Komisionit

Të pranishëm në mbledhje ishin:
Shkumbin Demalija, Bojan Stojanovič Emrush Xhemajli, Naim Maloku, Melihate Termkolli, Agim Veliu, Gani Geci, Zafir Berisha dhe Zylfi Merxha

Mungoi: Eqrem Kryeziu

Nga zyra mbështetëse morën pjesë: Nur Çeku, Biljana Petrović, Antigona Ibraj.

Mbledhja filloi në orën 11:00 në sallën N-225, në ndërtesën e Kuvendit të Kosovës, me këtë rend dite:

R e n d i i d i t ë s :

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i Procesverbalit të datës 07.05.2008
3. Miratimi i propozim-amendamenteve për Ligjin për Letërnjoftimin
4. Shqyrtimi i propozim-amendamenteve për Projektligjin për Sigurinë Private
5. Të ndryshme

Pika e parë: Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

Pika e dytë: Procesverbali i mbledhjes së datës 29.05.2008, u miratua pa vërejtje.

Pika e tretë: Në lidhje me këtë pikë kryesuesi i grupit punues Naim Maloku tha, ne i kemi shqyrtuar vërejtjet e UNMIK-ut, dhe kemi nxjerr këto propozim-amendamente për Ligjin për Letërnjoftimin. Mirëpo na ka mbetur një çështje pa zgjidhur sa i përket vendbanimit që është cekur në amendamentin 15, dhe për ta sqaruar këtë çështje, kërkoj t'ia japim fjalën përfaqësuesit të MPB-së.

Shkodran Manaj, përfaqësues nga MPB-ja, deklaroi se në bazë të konsultimeve kemi vendosur që amendamenti 15 të hiqet.

Gani Geci, kërkoj që të hiqet amendamenti 15, për arsye se shtetasit e huaj që marrin letërnjoftim të përkohshëm, ta kenë edhe adresën e vendbanimit, në mënyrë që të dihet se ku banojnë këta shtetas.

Melihate Termkollli, në lidhje me këtë çështje tha, po shihet se edhe ky Ligj si shumica e të tjerave është peng i afateve, dhe po e shoh se edhe ky Ligj është më shumë një improvizim dhe jo një zgjidhje reale e çështjes. Prandaj unë nuk do të votoj këto vërejtje, sepse duhet tu thuhet stop njëherë e përgjithmonë këtyre improvizimeve.

Të gjitha amendamentet për Ligjin për Letërnjoftimin përveç amendamentit 15 u miratuan me 9 vota për dhe një kundër.

Pika e katërt: Propozim-amendamentet për Projektligjin për Sigurinë Private u miratuan pa ndonjë ndryshim.

Pika e pestë: Në këtë pikë përfaqësuesi nga OSBE-ja, bëri një prezantim rreth organizimit të vizitës që do të bëhet në Gjenevë, me 2 deri me 4 qershor, në të cilën do të marrin pjesë shumica e anëtarëve të Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri.

Në këtë pikë gjithashtu Kryetari Rustem Mustafa, njoftoi anëtarët edhe për një ftesë që i është bërë komisionit për vizitë në Shqipëri, dhe propozoi që përfaqësues të jetë z.Zafir Berisha si dhe disa anëtar të tjerë të komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

Kryetari i Komisionit
Rustem Mustafa

